



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

**“PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË
ÇMIMIT TË AKSESIT NË INFRASTRUKTURË DHE ÇMIMET
REFERUESE TË AKSESIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 7, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, me propozimin e Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të aksesit në infrastrukturë dhe çmimet referuese, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas përcaktimeve në nenin 7, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË AKSESIT NË INFRASTRUKTURAT PASIVE DHE ÇMIMET REFERUESE

Neni 1 Objekti dhe qëllimi

Ky dokument ka si objekt përcaktimin e metodologjisë të përcaktimit të çmimit të aksesit, në rrjetet e infrastrukturës pasive, si dhe çmimet referuese të aksesit në këto rrjete, me qëllim zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, duke reduktuar kostot e ndërtimit të tyre, përmes bashkëpërdorimit të kapaciteteve të lira ekzistuese.

Neni 2 Përkufizime

Termet e përdorur në këtë dokument, kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në ligjin Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

“Akses”, në kuptimin e këtij vendimi, është bërja e disponueshme e infrastrukturës fizike pasive të rrjetit.

“Tarifa e aksesit”, në rrjetin e infrastrukturës pasive, në disa raste, sipas marrëveshjeve ekzistuese, ka të njëjtin kuptim me pagesën për qiranë e përdorimit të infrastrukturës fizike pasive (tubacioneve, shtyllave, pusetave etj.), të operatorit të rrjetit ose autoritetit disponues të tyre.

“Infrastrukturë fizike pasive”, është çdo element i një rrjeti, i cili ka për qëllim të hostojë elemente të tjera të një rrjeti, pa u bërë vetë një element aktiv i tij, siç mund të jenë tubacionet, kanalet/gypat, pusetat, instalimet e antenave, kullat, godinat ose hyrjet në godina.

“Operator rrjeti”, është një sipërmarrës i komunikimeve elektronike, që ofron ose është i autorizuar të ofrojë, rrjete të komunikimeve publike, sipas ligjit për komunikimet elektronike, si dhe çdo sipërmarrës që ofron infrastrukturë fizike të destinuar për ofrimin e:

a) shërbimit të prodhimit, transportit ose të shpërndarjes së:

i) gazit;

ii) energjisë, përfshirë edhe ndriçimin publik;

iii) ngrohjes;

iv) furnizimit me ujë, përfshirë kanalizimet ose trajtimin e ujërave të ndotura dhe të zeza, si dhe sistemin e drenazhimit;

b) shërbimeve të transportit, duke përfshirë hekurudhat, rrugët, portet dhe aeroportet.

Operator rrjeti do të konsiderohet bashkia, si dhe çdo subjekt juridik publik ose shtetëror, që ka në pronësi, apo administron infrastrukturë pasive të tubacioneve, të cilat mundësojnë vendosjen e rrjetit të komunikimeve elektronike.

“Autoritet përgjegjës”, në kuptimin e këtij dokumenti, janë autoritetet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të përcaktuar në nenin 7, të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

Neni 3 Parime të përgjithshme

1. Përcaktimi i çmimit të aksesit në rrjetet e infrastrukturës pasive, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga Autoriteti përgjegjës, sipas nenit 7 të ligjit nr. 120/2016 bazohet në:

- a. parimin e proporcionalitetit,
 - b. objektivitetit
 - c. mosdiskriminimit.
2. Autoriteti përgjegjës, në vendimin e tij, përfshin vendosjen e termave dhe kushteve të drejta, si dhe garanton që ofruesi të ketë mundësinë e mbulimit të kostove të dhënies së aksesit dhe një fitimi të arsyeshëm.
 3. Në përcaktimin e çmimit të aksesit, mbahet parasysh çmimi i tregut, tarifat mesatare të vendeve të rajonit, si dhe respektimi i parimeve të konkurrencës së ndershme dhe efektive.
 4. Çmimi i përcaktuar i aksesit në infrastrukturën pasive të rrjeteve, synon orientimin e tij në koston efiçente dhe nuk duhet të çënojë dhe të bjerë ndesh me të drejtat dhe interesat ekonomike të operatorit të rrjetit.

Neni 4

Aksesi në infrastrukturën pasive

1. Aksesi në infrastrukturën pasive të rrjetit të infrastrukturave përfshin:
 - a. aksesin në elementët pasivë të rrjetit:
 - i. tubacione,
 - ii. gypa,
 - iii. puseta
 - b. aksesin në shtylla
 - c. aksesin në kulla
 - d. aksesin në pikën e lidhjes/aksesit në godina
2. Aksesi në infrastrukturën pasive të rrjetit, nuk përfshin të drejten e aksesit për përdorimin e elementeve aktive të rrjetit.
3. Aksesi në infrastrukturën pasive, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, përfshin përdorimin e infrastrukturës inxhinierike civile ekzistuese.

Neni 5

Përcaktimi i çmimit të aksesit

1. Autoriteti përgjegjës rregullator për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, përcakton çmimin e aksesit, bazuar në një nga metodologjitë e miratuara në këtë vendim.
2. Vendimi për përcaktimin e çmimit të aksesit, kryhet nga autoriteti në konsultim me kërkuesin (operatori përfitues) dhe operatorin e rrjetit ofrues.
3. Në rastet kur mosmarrëveshja për çmimin e aksesit, është midis operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, AKEP vepron sipas parashikimeve në ligjin për komunikimet elektronike.

Neni 6

Metodologjitë për përcaktimin e çmimit të aksesit

1. Metodologjitë e rekomanduara për përcaktimin e çmimit të aksesit në infrastrukturë pasive, janë përkatësisht:
 - a) Çmimi bazuar në kosto – LRIC/BULRIC. Kjo metodë siguron që çmimi i aksesit të reflektojë kostot efektive, të operatorit të infrastrukturës. Çmimi i aksesit, duhet të mbulojë vlerën përkatëse të infrastrukturës të kërkuar për përdorim/bashkëpërdorim.

Në ndërtimin e modelit BU- LRIC, autoriteti përgjegjës, nuk supozon ndërtimin e një rrjeti të ri të tërë inxhinierik për rrjetin e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

- b) Aseti Bazë i Rregulluar –RAB (Regulatory Asset Base), që i korrespondon kostove të justifikuara të asetëve të infrastrukturës, që ofrohen për ripërdorim mbi bazën e kostove aktuale. Çmimi i llogaritur me këtë metodologji merr në konsideratë kohëzgjatjen në kohë “elapsed time”. Në rastin e aksesit në infrastrukturën inxhinierike ekzistuese, Autoriteti përgjegjës do të vlerësojë të gjitha asetet përberëse, bazuar në RAB të rrjetit të modeluar, mbi bazën e kostove zëvendësuese, përveç “reusable legacy civil engineering assets”
 - c) Metoda e indeksimit, do të aplikohet për llogaritjen e kostove korrente për RAB korrespondues, në asetet e ripërdorshme të infrastrukturës inxhinierike. Autoriteti përgjegjës do të vlerësojë asetet e ripërdorshme të infrastrukturës civile inxhinierike, mbi bazën e metodës së indeksimit.
 - d) Benchmark – Çmimet referuese. Autoritetet përgjegjëse mund të përdorin si alternative metodën e benchmarkut, mbi bazën e praktikave më të mira në vendet e krahasueshme dhe tarifatat e aplikuar në vend.
2. Autoriteti përgjegjës detajon me rregullore, metodologjinë e përcaktimit të çmimit për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës pasive të rrjetit, për infrastrukturën/at përkatëse të fushës që mbulon.
 3. Rregullorja/et, sipas pikës 2 të këtij neni, publikohet/hen në faqen zyrtare të autoritetit përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 7

Vendosja e çmimit të aksesit

1. Vendosja e çmimit të aksesit të rrjetit bazohet në këto kërkesa:
 - a) Tarifatat e aksesit në rrjet, do të pasqyrojnë kostot reale të rrjetit.
 - b) Tarifatat e aksesit në rrjet, do të llogariten në mënyrë të tillë që, në fund të periudhës rregullatore, diferenca ndërmjet kostove reale të rrjetit (të ardhurave të realizuara) dhe atyre të lejuara nëpërmjet tarifës, të jetë sa më e vogël.
 - c) Tarifatat e aksesit në rrjet, duhet të pasqyrojnë kostot aktuale të ofrimit të shërbimit të aksesit për operatorin kërkues dhe duhet të alokohen në mënyrë sa më të drejtë.
 - d) Tarifatat e aksesit në rrjet, duhet të reflektojnë kostot e operimit me efikasitet të rrjetit.
 - e) Tarifatat e aksesit në rrjet, duhet t'i lejojnë operatorit të rrjetit, të përfitojë normën e lejuar/të arsyeshme të kthimit të investimit.
 - f) Tarifatat e aksesit në rrjet duhet të mbeten të qëndrueshme në kohë.
2. Në analizën e kostove të operatorit ofrues, Autoriteti përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ka të drejtën të shqyrtojë nivelin e kostove të raportuara nga operatori i rrjetit dhe zbaton parimet si më poshtë:
 - a) Kostot e paraqitura në pasqyrat financiare të operatorit të rrjetit do të merren parasysh, deri në masën që ato përkojnë me kostot që do të kishte një operator rrjeti eficient dhe i mirëmenaxhuar dhe që do të shmangte shpenzimet e tepërta.
 - b) Në përcaktimin e çmimit të aksesit, do të merren në konsideratë vetëm ato kosto apo komponentë të tyre, që kanë të bëjnë me dhënien e aksesit në infrastrukturën fizike

ekzistuese, pa e ngarkuar me kosto të nevojshme për kryerjen e aktivitetit nga vetë operatori ofrues për qëllime të tij.

- c) Operatori i rrjetit ofrues, duhet të justifikojë kostot me dokumentacionin përkatës.
- d) Autoriteti përgjegjës nuk do të konsiderojë në llogaritje vlerën e aseteve ligjërish të amortizuara, por që janë ende në përdorim.
- e) Autoriteti përgjegjës, vendos kohën e aseteve inxhinierike, në një periudhë që i korrespondon kohës së pritshme për të cilën aseti është në përdorim mbi bazën e llojit të tij. Jetëgjatësia në rastin e tubacioneve është jo më e vogël se 40 vjet.

Neni 8

Çmimet referuese

1. Çmimet referuese për aksesin në infrastrukturë, për një periudhë dyvjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, jepen në shtojcën I të këtij vendimi.
2. Çmimet referuese rishikohen periodikisht, por jo më pak se çdo dy vjet.

ÇMIMET REFERUESE

- I. Tarifa e aksesit për shtrirjen e kablove të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë (fibra optike) në tubacionet në pronësi shtetërore është:
 - a) Për dhënien e aksesit për të gjithë hapësirën e tubacionit: 39 lekë/ml/vit;
 - b) Për dhënien e aksesit në bashkëpërdorim nga më shumë se një përdorues: 13 lekë/ml/vit;

- II. Tarifa e aksesit në shtylla të infrastrukturave ekzistuese ku vendosen kablo të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë (fibra optike) është:
 - a) 55 lekë/muaj/shtyllë;
 - b) 35 lekë/muaj/shtyllë në zonat rurale;